



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za žalbe i Predstavke

A.nr.994/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Afijete Sada Glllogjani kryesuese, Zyhdi Haziri dhe Kymete Kicaj anëtarë, duke vendosur perkitasi me apelin e Kandidatit për antarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Lipjanit, Rinor Retkoceri, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) më seli në Prishtinë, dega në Komunen e Lipjanit, paraqitur kundër vendimit me numer 2948-2021 i datës 03.11.2021, Të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021. Për kuvendin komunal në senacën e Panelit të mbajtur, me datë 07.11.2021. mori këtë;

V E N D I M

Hudhet i parregullt apeli Anr.994/2021 i paraqitur nga Kandidati për antarë të Kuvendit Komunal, i komunës së Lipjanit, Rinor Retkoceri nga subjekti politik Partia Demokratik e Kosoves (PDK) me seli në Prishtinë dega në Komunën e Lipjanit paraqitur kundër vendimit me nr 2948-2021 i datës 03.11.2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet lokale 2021 për kuvendin komunal.

A r s y e t i m

Me datën 04.11.2021 PZAP-i ka pranuar një apel nga kandidati për antarë të Kuvendit Komunal i Komunës së Lipjanit Rinor Retkoceri nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë dega në Lipjan, në të cilin pretendon dhe deklaron se me votat e tij është bërë manipulim dhe vjedhje votash, se i mungojnë edhe votat e familjarëve të tij dhe kërkon nga PZAP që ta shqyrtoj apelin dhe të merr vendim për ri-numërim të votave. Parashtruesi i apelit si dëshmi i ka bashkangjitur emrat e deshmitarve, familjarëve që e kanë votuar dhe numrat personal të tyre dhe adresat., por nuk e ka nënshkruar formularin e apelit.

Paneli, pasi që vlerësoj apelin gjeti se i njëjti është **i parregullt**, për këto arsye:

Nga shkresat e lëndës vërtetohet se apeli i paraqitur, është i parregullt, pasi që Apeli i paraqitur në PZAP nga Rinor Retkoceri., nuk i plotson kushtet ashtu siq parashihet në nenin 10.6 dhe 7 të Rregullores nr .07/2015 për rregullat dhe procedurat PZAP –it ku *“Apelet duhet të dorëzohen me shkrim e të jenë të nënshkruar nga ana e parashtruesi i apelit, apo në emër të tij nga personi i*

autorizuar, në rastet kur parashtruesi i apelit/ankuesi-ja, është parti politike, koalicion, iniciativë qytetare, ose çfarëdo personi tjetër juridik, apeli duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi i autorizuar i atij personi juridik siç është përcaktuar në rastet ku kjo është e mundshme në çfarëdo dispozite ligjor në fuqi” dhe “Personi që e dorëzon apelimin duhet të përdorë formularin e gatshëm për apelim”. Të gjitha apelimet duhet të kenë së paku informacionet vijuese:

- a) emrin, adresën dhe informacionet për kontaktim të personit që e dorëzon apelimin
- b) arsyen për dorëzimin e apelimt
- c) hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të personit që e dorëzon apelimin apo udhëzimin se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të parashtruesit të apelimt
- d) vërtetimin nga personi që e dorëzon apelimin lidhur me vërtetësinë e përmbajtjes së apelimt.

Në rastin konkret parashtruesi i apelit nuk e ka nënshkruar formularin e apelit dhe hudhet i pa rregullt.

Prandaj Paneli, nuk u lëshua fare në vlerësimin e meritave të apelit, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozita e lartcekur. PZAP, në këtë fazë që gjendet procesi zgjedhor, nuk mund të merr vendim tjetër sepse fillimisht parashtruesi i apelit nuk i plotëson kriteret për të ushtruar apel në PZAP, ashtu siç u vlerësua më lartë. Për këto arsye Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga arsyet e lartcekura e në mbështetje të dispozitave të Rregullës Nr.02/2015 për Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A.nr. 994/2021, më datën 07.11.2021

Kryesuesja e Panelit
Arijete Sada Glllogjani

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa, sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimt të këtij vendimi.